



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 116, Datë 21.04.2026

MBI

**MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET BARRËSIMIT) TË ASETETEVE FIKSE TË SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY” SH.P.K., SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SH.A.**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, germa “b”, nenit 6, 7 dhe 8 të *Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licensuarit*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikave 1.3 dhe 1.6 të “*Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike*” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 620/8 prot., datë 17.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “*Mbi kërkesën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sha për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të asetëve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sha,*

**Konstatoi se:**

- Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

**1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit**

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.01.2025, nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 1451, Fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Me shkresën nr. 620 prot., datë 11.02.2026 shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k. ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e asetëve fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a. *Duke qenë se në këtë aplikim u konstatuan mungesa/pasaktësi, u zhvillua korespondenca përkatëse me shoqërinë/bankën dhe në datë 24.02.2026 u depozitua dokumentacioni i saktësuar, ndaj afati procedural i këtij aplikimi është konsideruar data 24.02.2026.*

**2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Kërkesa për Dokumentacion Plotësues**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 71, datë 10.03.2026, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë.

- ERE shkresën nr. 620/4 prot., datë 18.03.2026 dhe emailin e datës 25.03.2026 ka njoftuar shoqërinë për vendimin nr. 71/2026, si dhe i ka kërkuar të sqaroje/bëjë me dije lidhur me rolin që bashkëkredimarrësi, shoqëria “KASTRATI” sh.p.k. ka në kredinë e nënshkruar. Gjithashtu për vendimin nr. 71/2026 është njoftuar edhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

### 3. Dorëzimi i Dokumentacionit Plotësues

- Me shkresën nr. 620/6 prot., datë 31.03.2026 shoqëria/banka kanë përcjellë informacionin e kërkuar në këtë aplikim.

### 4. Përfundime dhe Kërkesa të tjera për Dhënien e Autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Sunny Side Energy sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 4, 6, 7 dhe 8, të “*Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licensuarit*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, si vijon:
- Neni 4, gërma b – Për transferimin e asetëve të të licensuarve me kapacitet te instaluar nën 1 MW, nuk ka nevojë për miratimin e ERE. Për të gjithë të licensuarit e tjerë *do të kërkohet miratimi i ERE-s për transferim të asetëve kur vlera e asetit që kërkohet të transferohet është më e madhe se 150.000.000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë.*

### 5. Plotësimi i Kërkesës sipas nenit 7:

- **Pika 1** - Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi kërkesën për transferim, ndër të tjera si më poshtë vijon:
  - **Gërma “a”** – Është depozituar Ekstrakti historik i shoqërisë, i vlefshëm brenda afatit ligjor;
  - **Gërma “b”** – Është plotësuar informacioni mbi veprimtarinë e licensuar;
  - **Gërma “c”** – Është plotësuar informacioni mbi gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efekti i pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve;
  - **Gërma “d”**- Është bërë një përshkrim i kandidatit;
  - **Gërmat “e” “f” dhe “g”** – Arsyet e kërkesës, efektet në aktivitetin e licensuar dhe furnizimin e klientëve;
  - **Gërma “h”** – Janë depozituar Kontratat/Marrëveshjet përkatëse; -
    - *Kontratë Kredie me nr. 7775 rep, nr. 2810 kol, datë 26.12.2025, nënshkruar nga palët, që do të shërbejë për rikthimin e pjesshëm të fondeve të dhëna nga ortaku dhe/ose borxhit brenda grupit të shoqërive dhe/ose financimi i detyrimeve ndaj furnitorit deri në masën 60% të koston totale të projektit (pa përfshirë TVSH-në).*
    - *Marrëveshje Siguruese nr. 1083 rep., nr. 458 kol., datë 24.02.2026, me anë të të cilës është rënë dakord të vendoset në favor të barrëmarrësit asetet fikse të shoqërisë.*
  - **Gërma “i”** – Deklarata e kredidhënësit për garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit;
  - **Gërma “j”** – Deklarata dhe vërtetimi për mungesë transferimesh të mëparshme mbi asetet fikse.
- **Pika 3** – Është plotësuar informacioni i kërkuar në këtë pikë që lidhet me detyrimet me të cilat ngarkohet subjekti për shkak të marrëveshjes së koncesionit në pjesët që transferojnë tek përfituesi përfshirë edhe informimin e Autoriteti Shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të asetëve.
- **Pika 4** – Kërkesa për aplikim është nënshkruar nga administratori i shoqërisë, ndërsa dokumentet e tjera shoqëruese të këtij aplikimi janë nënshkruar nga administratori dhe/ose personat e autorizuar sipas rastit.
- **Pika 6** – Shoqëria ka bërë me dije se nuk ka pjesë të dokumentacionit në këtë aplikim që

konsiderohet se nuk duhet të jetë i hapur për publikun.

## **6. Kushtet e Vendosura për Dhënien e Autorizimit**

- Dhënia e autorizimit nga ERE transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve fikse të saj (sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi), si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sha, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi asetet e shoqërisë për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi asetet e saj ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Sunny Side Energy” shpk për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguroese) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a. (*për kontratën e kredisë nr. 7775 rep, nr. 2810 kol, datë 26.12.2025 dhe marrëveshjen siguroese nr. 1083 rep., nr. 458 kol., datë 24.02.2026*). (Lista e aseteve bashkëlidhur)
2. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 nuk e çliron shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
3. Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi asetet e paluajtshme të saj që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm, si dhe në rast të çdo ndryshimi në këtë marrëveshje përfshirë transferimin te të tretët.
4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria dokumenton heqjen e barrës siguroese të radhës së parë të vendosur mbi asetet e saj, apo depozitimin e ndonjë dokumenti/qëndrimi të ndryshëm nga organet/institucionet në lidhje me këtë projekt, që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**